



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

VENDIM

Nr.191, datë 27.06.2023

PËR

**“RENDITJEN E KANDIDATËVE PËR POZICIONIN VAKANT NR.5 NË
PROKURORINË PRANË GJYKATËS SË SHKALLËS SË PARË TË
JURIDIKSIONIT TË PËRGJITHSHËM DURRËS, SHPALLUR ME VENDIMIN
NR.92, DATË 09.05.2023 TË KËSHILLIT TË LARTË TË PROKURORISË”**

Bazuar në nenin 149/a të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenin 90, pika 2 të “Kodit të Procedurave Administrative”, nenin 43 të ligjit Nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, nenet 164 pika 8, 166 pika 2, 189 pika 1, germa “a” të ligjit Nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” i ndryshuar, nenin 43 dhe 44 të Rregullores “Për transferimin e prokurorëve nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele” të ndryshuar, si dhe relacionin shpjegues të përgatitur nga Komisioni për Zhvillimin e Karrierës, Këshilli i Lartë i Prokurorisë,

VENDOSI:

- I. Miratimin e renditjes së kandidatëve për pozicionin vakant Nr.5, shpallur me vendimin e Këshillit të Lartë të Prokurorisë Nr.92, datë 09.05.2023, në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Durrës si më poshtë:
 1. Ilir Hoxha
 2. Elidon Hysenaj
- II. Mos vazhdimin e procedurës së transferimit nëpërmjet lëvizjes paralele, për kandidatët Alba Dhima, Albjona Papajani dhe Erida Visoçi.
- III. Relacioni i Komisionit për Zhvillimin e Karrierës është pjesë përbërëse e këtij vendimi.
- IV. Të njoftojë të gjithë kandidatët për këtë vendim.
- V. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e njoftimit të këtij vendimi.
- VI. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare web të Këshillit.
- VII. U shpall në Tiranë, sot më 27.06.2023.




KRYETAR
Alfred Balla

KËSHILLI I LARTË I PROKURORISË

ZV/KRYETAR
Tartar Bazaj


ANËTAR
Sokol Stojani


ANËTAR
Bujar Sheshi


ANËTAR
Nurihan Seiti


ANËTAR
Elaida Coxhi


ANËTAR
Esmeralda Keshi


ANËTAR
Zeqir Hoda


ANËTAR
Mirrela Bogdani


ANËTAR
Arta Mandro


ANËTAR
Ledina Riza

